

Dr. Musa Musai

PERCEPTIMET E IDENTITETIT SOCIAL DHE FETAR TË SHQIPTARËVE NË MAQEDONI DHE TURQI

Hyrje:

Ky punim është një rezymë e temës së magistraturës të punuar në vitin 1998 në Universitetin e Marmarasë, Instituti i shkencave sociale, dega Psikologjia e religjionit. Temë e këtij studimi ka qenë hulumtimi dhe përshkrimi i perceptimeve (kognicioneve) të identitetit etnik dhe fetar të shqiptarëve në Maqedoni dhe Turqi.

Duke u nisur nga thënia e Sokratit “njihe vetveten!” si një ndër elementet më të rëndësishme të çështjes së identitetit, edhe ne jemi munduar që në këtë frymë t’i analizojmë perceptimet e shqiptarëve të cilët jetojnë në Maqedoni dhe në Turqi në lidhje me etnitetin dhe qëndrimet fetare të tyre. Punimi ynë temë studimi të vet ka “perceptimet në lidhje me identitetin social dhe fetar”. Mu për këtë në këtë studim janë shfrytëzuar metodat e psikologjisë sociale me anë të të cilave jemi munduar që t’i nxjerrim profilet e perceptimit të identitetit social dhe fetar të shqiptarëve të këtyre dy shteteve.

Kjo temë nga njëri aspekt hyn në lëmin e psikologjisë sociale ndërsa nga aspekti tjetër i përket dhe është në lidhshmëri të ngushtë me psikologjinë e fesë. Për arsye se mes temave me të cilat merret psikologjia e fesë në radhë të parë hyjnë edhe çështjet siç janë: kush është njeriu, ç’është besimi, qëndrimet, identiteti i tij, e në veçanti ndikimi i fesë në identitetin e tij ose në jetën shoqërore dhe niveli i këtij ndikimi fetar. Duke pasur parasysh se studimi ynë ka hulumtuar dhe shqyrtuar lidhshmërinë mes termave “identitet” dhe “fe”, aspekti i analizimit tonë është përqendruar në spektrin psiko-social dhe në atë fetar.

Një ndër arsyet të cilat na kanë nxitë në hulumtimin e këtyre çështjeve tek shqiptarët ka qenë mungesa e madhe e studimeve psiko-sociale me metoda shkencore në trevat tona, me përjashtim të studimeve në lëmi të historisë, siç janë punimet e Muhamet Pirakut, Ferit-Sevdije Shehut, Pajazit Nushit etj.

Në Perëndim studimet psiko-sociale janë të shumta, të gjitha ato studime janë të realizuara me anë të metodave shkencore pragmatike siç janë anketimi, reportazhet, testet, analizimet statistikore etj.

Në vitet e fundit shihet qartë se një ndër problematikat më tërheqëse të psikologjisë sociale është njohja e vetes (individuas), që do të thotë ta kuptosh veten, të njohësh se cilit etnitet i takon, të kesh një qëndrim në lidhje me atë se kush je e kështu me radhë.¹

Edhe ne, duke parë numrin e shumtë të këtyre punimeve si në shtetet perëndimore ashtu edhe në Amerikë vendosëm që brenda mundësive tona t'i rrekemi një studimi të këtillë ku tema kryesore të hulumtimit tonë do të ishin:

1. Ngjashmëritë dhe dallimet në lidhje me identitetin social dhe fetar mes shqiptarëve të Maqedonisë dhe Turqisë.
2. Mënyra e perceptimit të identiteti social dhe fetar
3. Qëndrimet e tyre në lidhje me jetën familjare
4. Gjendja e qëndrimeve në aspekt të mbajtjes së traditave
5. Ngjashmëritë e shqiptarëve të Maqedonisë dhe Turqisë në aspekt të jetës fetare.

Qëllimi i studimit:

Siç e thamë në fillim, në këtë punim janë zgjedhur dy grupe njerëzish të një etniteti por që jetojnë në rrethana të ndryshme socio-ekonomike. Mu për këtë, qëllimi parësor i këtij punimi ka qenë nxjerrja dhe konstatimi i strukturës kognitive të këtij etnikumi në lidhje me identitetin etnik dhe fetar të tyre.

Një tjetër qëllim i këtij punimi ka qenë nxjerrja në shesh e ngjashmërive dhe dallimeve mes shqiptarëve të Turqisë dhe Maqedonisë në bazë të të arriturave në lidhje me perceptimet e identitetit etnik, jetës sociale dhe qëndrimeve të tyre në lidhje me traditën shqiptare; ndaj kësaj të konstatuarit dhe të përshkruarit e vlerave socio-kulturore si dhe pasurinë e përbashkët që vjen nga tradita e tyre.

Gjithashtu, studimi ka pasur për qëllim që të bëjë hulumtimin dhe verifikimin e gjendjes së fetarisë së tyre. Qëndrimet dhe sjelljet e tyre ndaj kushteve të jetës fetare siç janë besimi fetar, adhurimet dhe veprimet fetare si dhe ndikimi fetar në jetën e përditshme të tyre.

Pas të gjitha këtyre sqarimeve është e rrugës që të prezantojmë vijën dhe metodën e ndjekur gjatë këtij studimi për të arritur deri te këto të dhëna.

¹ Berger, L. Peter, *Identity as a Problem in the Sociology of Knowledge*, Londër, 1983, f. 32.

Metoda:

Metoda, është një art i cili mundëson nxjerrjen në shesh të gjërave të panjohura dhe argumentimin ose verifikimin e çështjeve të njohura si tërësi. Thënë ndryshe, termi metodë ka kuptimin e rrugës, e cila duhet trasuar për nxjerrje në shesh të marrëdhënieve mes lidhshmërisë shkak-pasojë (kauzalitetit) dhe në suaza të mundësive të vërtetohet ligjet abstrakte shkencore të cilat zënë vend në themelet e këtyre marrëdhënieve.²

Në studimin tonë me qëllim të vërtetimit më preciz të “perceptimeve në lidhje me identitetin social dhe jetën fetare”, janë shfrytëzuar metoda dhe teknika të cilat përdoren në psikologjinë sociale dhe psikologjinë e fesë. Kjo është bërë me arsye që studimi të jetë më i tërësishëm dhe më përfshirës. Në këtë rast është përdorur metoda e “intervistimit” ose thënë më drejt, duke përfituar nga “Envanteri i Identitetit Social” të Zavallon-it është përdorur teknika psikologjike e “vet analizës së fokusuar”.³

Metoda e intervistimit është realizuar me pyetje të hapura me qëllim të tubimit të njohurive më precize. Takimi me të intervistuarit është bërë drejtpërdrejt dhe në formë të dialogut reciprok; takimi me të intervistuarit sy më sy ka mundësuar që në tubimin e të dhënave të fitohet sqarim i pastër dhe saktësi definitive. Me rëndësi të posaçme është të përmendet se gjatë kërkimit prej të intervistuarve që të përshkruajnë veten (shqiptarët) ata kanë cekur veçori të ndryshme. Ana pozitive e përdorimit të kësaj metode është se gjatë përshkrimit të tyre të shqiptarëve, për cilësitë e paqarta ose pak të qarta ka ekzistuar mundësia e pyetjeve plotësuese në lidhje me atë veçori të paqartë, që do të thotë se për çdo cilësi të potencuar nga të intervistuarit janë lypur sqarime dhe definime precize se ç’kanë pasur për qëllim të potencojnë me veçorinë e potencuar; njëkohësisht kjo metodë ka anuluar mundësinë e kuptimit të gabuar ose analizimit të cunguar të cilësive të potencuara nga ata.

Pjesëmarrësit në studim dhe veçoritë e tyre:

Të dhënat në këtë punim janë tubuar brenda intervalit kohor nëntor 1997 - mars 1998. Sa u përket të dhënave në lidhje me të intervistuarit dhe veçorive demografike të tyre, disa nga ato do t’i paraqesim me anë të tabelave e disa do t’i sqarojmë vetëm me anë të tekstit.

² Arslantürk, Zeki; “Sosyal Bilimciler İçin Araştırma Metod ve Teknikleri”, M.U. İlahiyat Fakültesi, Stamboll, 1995, f. 29.

³ Bilgin, Nuri, “Sosyal Psikolojide Yöntem ve Pratik Çalışmalar”, Sistem Yayıncılık, Stamboll, 1995, f. 70.

Tabela 1: Shpërndarja e të intervistuarve sipas gjinisë

Gjinia	Turqi		Maqedoni		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%
Femra	34	42,5	36	42,85	70	42,75
Meshkuj	46	57,5	48	57,15	94	57,25
Total	80	100	84	100	164	100

Nga tabela nr. 1 del në shesh se prej 164 pjesëmarrësve 80 janë prej grupit shqiptar nga Turqia, ndërsa grupi i shqiptarëve nga Maqedonia përbëhet prej 84 pjesëmarrësve. Në bazë të gjinisë del se nga të intervistuarit që jetojnë në Turqi 42,5% (36 veta) janë femra ndërsa 57,5% (48 veta) janë meshkuj. Te të intervistuarit nga Maqedonia 42,85% janë femra ndërsa 57,15% janë meshkuj.

Tabela 2: Shpërndarja e të intervistuarve në bazë të gjendjes martesore:

Gjendja martesore	Turqi		Maqedoni	
	N	%	N	%
Beqar	16	20	10	11,9
I martuar	58	72,5	66	78,5
I ve	4	5	2	2,5
I fejuar	2	2,5	6	7
Gjithsej	80	100	84	100

Sa i përket gjendjes martesore kuptohet se nga të intervistuarit e Turqisë 72% (58) prej tyre janë të martuar, 20% (16) beqarë, 5% (4) të ve dhe 2,5% (2) të fejuar.

Ndërsa tek të intervistuarit nga Maqedonia del se 78,5% (66) janë të martuar, 11,9% (10) beqarë, 7% (6) të fejuar dhe 2,5% (2) të ve.

Ndërsa në aspekt të gjendjes arsimore nga të intervistuarit e Turqisë 40% kanë të kryer shkollën e mesme ose licenë, 22,5% (18 persona) kanë të kryer tetëvjeçaren, një grup prej 12,5% kanë kryer shkollën e lartë ose universitetin, ndërsa në dy grupet e fundit me nga 7,5% janë ata që dinë shkrim-lexim e në tjetrin grup bëjnë pjesë ata që s'dinë shkrim-lexim.

Te të intervistuarit nga Maqedonia gjendja është kështu: 42% janë me shkolla të mesme, 26% janë me shkollë të lartë ose universitet, 21% janë me shkollë fillore dhe me 7% merr pjesë grupi që s'di shkrim-lexim.

Teknika e tubimit të njohurive:

Si mjet i tubimit të materialit përkatës, është shfrytëzuar modeli i “Envanterit të Identitetit Social” të Zavallon-it, ndërsa si teknikë kryesore është përdorur metoda e njohur si “Introspekcioni i Posaçëm”. Zavalloni hulumtimin e tij e ka bërë duke kërkuar prej studentëve amerikanë dhe francezë që ta përshkruajnë veten edhe atë me këto pyetje të cilat njihen si njësi standarde të identitetit social:

Pyetje: “Ju si një francez / amerikan, si do t’i kishit përshkruar francezët/ amerikanët sikur ju?”

Përgjigje: “unë si francez / amerikan...” dhe në këtë formë ka arritur që me anë të shtatë pyetjeve të parashtruara ndaj studentëve të të dyja vendeve të nxjerrë një profil të identitetit social të amerikanëve dhe francezëve.

Ndërsa në rastin e studimit tonë prej të intervistuarve është kërkuar që ta përshkruajnë grupin e tyre të brendshëm të cilit edhe ata vet i takojnë, e nuk është kërkuar prej tyre që të bëjnë krahasime mes shqiptarëve të Turqisë dhe Maqedonisë.

Pyetjet u janë parashtruar veç e veç të gjithë të intervistuarve nga të dyja grupet, p.sh. atij të Maqedonisë pyetjet i janë parashtruar:

1. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar shqiptarët e Maqedonisë?”

Ndërsa të intervistuarve nga Turqia:

“Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar shqiptarët e Turqisë?”

Pyetjet të cilat u janë parashtruar të intervistuarve në lidhje me identitetin social kanë qenë:

2. “Ju si një shqiptar, si do ta kishit përshkruar mashkullin shqiptar të Maqedonisë/Turqisë?”

3. “Ju si një shqiptar, si do ta kishit përshkruar femrën shqiptare të Maqedonisë/Turqisë?”
4. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar moshatarët tuaj shqiptarë të Maqedonisë/Turqisë?”
5. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar në aspekt të profesionit shqiptarët e Maqedonisë/Turqisë?”
6. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar në aspekt të jetës familjare shqiptarët e Maqedonisë/Turqisë?”
7. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar në aspekt të jetës sociale shqiptarët e Maqedonisë/Turqisë?”

Ndërsa pyetjet që u janë parashtruar në lidhje me identitetin fetar kanë qenë:

8. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar në aspekt të jetës fetare shqiptarët e Maqedonisë/Turqisë?”
9. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar në aspekt të besimit fetar shqiptarët e Maqedonisë/Turqisë?”
10. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar në aspekt të ushtrimit të riteve fetare (ibadeteve) shqiptarët e Maqedonisë/Turqisë?”
11. “Ju si një shqiptar, si do t’i kishit përshkruar shqiptarët e Maqedonisë/Turqisë në aspekt të ndikimit fetar në jetën sociale?”

Analiza statistikore:

Në fillim të dhënat në lidhje me punimin tonë janë futur në programin statistikor STATVIEW 512 dhe në bazë të këtij programi është bërë analiza faktoriale me anë të së cilës janë hulumtuar të dhënat në bazë të pjesëve themelore të analizimit (Principle Component Analysis), e më pastaj është bërë studimi i numrit të faktorëve dhe vlerave personale (Eigen Value) të bëra në lidhje me veçoritë e potencuara.

Të dhënat e marra, përbëhen prej thënieve të përshkrimit të identitetit social dhe fetar të të intervistuarve që ata i kanë paraqitur në lidhje me çdo pyetje të parashtruar. Thëniet apo cilësitë e ngjashme mes veti janë bashkuar dhe kështu janë emërtuar me nocionin titull, ndërsa disa tituj të ngjashëm kanë themeluar një kategori, p.sh: nga thëniet e potencuara siç janë: *-Jetën e jep nga fjala nuk kthen; -Kanë besë; -Popull i besës; -Kanë të vetmen veçori ‘fjalën e dhënë’; -Nuk tradhton...* është formuar një titull me nocionin "të besës" meqë të gjitha këto thënie janë të ngjashme mes veti. Ndërsa nga disa tituj që kanë përmbajtje të cilësive personale është formuar një kategori me disa tituj të ngjashëm, p.sh.: *-Të besës; -Të moralshëm; -Inatçorë-nervozë; -*

Thashethënës... dhe me këta tituj është formuar kategoria "personaliteti-karakteri", e njëjta metodë është aplikuar edhe me thëniet dhe titujt e tjerë në përgjithësi. Cilësitë e tubuara në tituj dhe kategori më pastaj secilës prej tyre i është bërë vlerësimi nga ana e të intervistuarve edhe atë si cilësi "pozitive, negative dhe neutrale", e më pastaj prej tyre është marrë edhe pëlqimi se cilësia e potencuar atyre personalisht "u përshtatet ose nuk u përshtatet" d.m.th cilësia gjendet ose nuk gjendet te i intervistuari. E më pas është bërë vlerësimi me pikë i çdo cilësie në bazë të asaj që i intervistuari e ka potencuar. Pikësimi është bërë në këtë mënyrë:

Përshtatet (psh) - pozitive (+) = 6 pikë (që do të thotë se nëse një veti është vlerësuar me këto shenja ka marrë 6 pikë).

Përshtatet (psh) - neutrale (.) = 5 pikë

Përshtatet (psh) - negative (-) = 4 pikë

Nuk përshtatet (np) - pozitive (+) = 3 pikë

Nuk përshtatet - neutrale (.) = 2 pikë

Nuk përshtatet - negative (-) = 1 pikë

Të arriturat:

Në këtë pjesë të punimit do të mundohemi që në disa pika të shkurtra t'i paraqesim të arriturat e këtij hulumtimi në lidhje me identitetin social të shqiptarëve në Maqedoni dhe Turqi, e më pastaj do të raportojmë edhe në lidhje me të arriturat e identitetit fetar të shqiptarëve që jetojnë në këto dy shtete të sipërpërmendura.

Temat të cilat do të analizohen në këtë pjesë janë:

1. Perceptimet në lidhje me identitetin social
2. Qëndrimet dhe sjelljet në lidhje me jetën fetare
3. Marrëdhëniet mes identitetit etnik dhe fetar

1. Të arriturat në lidhje me identitetin social:

Në këtë nëntitull do të raportohet në lidhje me perceptimet e identitetit social të shqiptarëve në Maqedoni dhe Turqi; identiteti i cili përbëhet prej: origjinës, gjinisë, gjeneratës, profesionit (punës), gjendjes familjare dhe jetës sociale. Dhe tash do të fillojmë prej njësisë së parë të identitetit social e deri te njësia e shtatë që është jeta sociale.

Në këtë pjesë të punimit para se të fillojmë me raportimin e të dhënave, do të paraqesim nga një tabelë prej të arriturave në lidhje me origjinën prej të dyja grupeve të intervistuar me qëllim që sa më lehtë të orientohemi në hulumtimin tonë.

a. Të arriturat lidhur me perceptimin e identitetit social

1. Të arriturat që kanë të bëjnë në lidhje me perceptimet e shqiptarëve të Turqisë në përshkrimin e shqiptarëve në aspekt të origjinës etnike të shqiptarëve të Turqisë potencojnë se, shqiptarët që jetojnë në Turqi në pyetjen: "Ju si një shqiptar, si do t'i kishit përshkruar shqiptarët e Turqisë"? nga përgjigjet e dhëna të tyre kuptohet se cilësi më të potencuar të tyre janë: "Punëtorë" (me 44 thënie), "Të besës" (me 38 thënie), "I janë përshtatur shoqërisë turke" (me 34 thënie), "E mbajnë traditën" (me 32 thënie), dhe veçoria "Të mirëkuptimtë" (me 30 thënie).

Nga këto veçori të potencuara të tyre, thënia "janë punëtorë" me 268 pikë është cilësia më pozitive dhe më e përshtatshme për ta. Ndër cilësitë tjera më pozitive të tyre hyjnë edhe veçoritë: "Të besës", "Mbahen mes veti" dhe "Mikpritës".

Cilësi të cilat gjenden tek ata e që nga vlerësimi i tyre konsiderohen si negative janë: "Janë çallëmxhinj" dhe veçoria "E pëlqejnë veten".

Ndërsa sa u përket të arriturave me të intervistuarit nga Maqedonia konkludojmë se veçori më të theksuara të tyre dalin: "Janë kombëtarë-trima"(60 thënie), "Të besës" (40 thënie), "Fetarë" (34 thënie), "Të shtypur-nuk kanë të drejta" (30 thënie), dhe "tolerantë" (26 thënie).

Duhet theksuar se në bazë të vlerësimit të përshtatshmërisë dhe pozitivitetit mund të konstatojmë se cilësitë: "Kombëtarë-trima", "Tolerantë" dhe "Fetarë" janë cilësitë me vlerësim më pozitiv.

Mes këtyre thënieve vend të posaçëm ka zënë edhe gjendja e potencuar "Të shtypur-s'kanë të drejta" e cila në përgjithësi është vlerësuar si negative dhe e papërshtatshme.

2. Sa u përket të arriturave në lidhje me pyetjen e dytë që u është parashtruar të dyja grupeve të të intervistuarve në lidhje me meshkujt shqiptarë, është konstatuar se te grupi i të intervistuarve nga Turqia veçoritë më të dalluara të mashkullit shqiptar në Turqi janë: "Punëtorë" (46 thënie), "I dhënë pas familjes" (34 thënie), "I besës" (32 thënie), "I pavarur në punë" (22 thënie).

Te këto veçori të theksuara është vërejtur se thënia "Punëtorë" është veçori e cila nga të gjithë të intervistuarit është vlerësuar me 'përshtatet-pozitive' dhe me 268 pikë del si veçoria më e preferuar e tyre. Edhe pse, në këtë kategori të veçorive të pëlqyera nga

ata mund të numërohen edhe cilësitë: "Të besës", "Të suksesshëm në punë", "Të dhënë pas familjes" e kështu me radhë.

Veçori negative të mashkullit shqiptar të Turqisë paraqiten: "Inatçorë", "Nervozë" edhe "Mbisundon mashkulli".

Për të arriturat e të intervistuarve nga Maqedonia në lidhje me përshkrimin e mashkullit shqiptar është verifikuar se veçori më të përshtatura janë: "Kombëtarë-trima", "Të besës", "Punëtorë", "Të dhënë pas familjes" dhe kështu me radhë.

Prej vlerësimeve të përshtatshmërisë dhe pozitivitetit të cilësive të potencuara kuptohet qartë se "Mbajtja e besës" për ta është cilësia më e preferuar dhe më pozitive. Si cilësi të pëlqyera konsiderohen edhe thëniet "Kombëtarë-trima", "Të arsimuar", "Të aftë", "Me karakter", "Fetarë", etj.

Cilësi jo të preferuara të mashkullit shqiptar nga Maqedonia kanë dalë thëniet: "Xhelozë", "Gurbetqarë", "Me gjendje të dobët ekonomike", etj.

3. Në pyetjen tonë të parashtruar grupit të intervistuar nga Turqia: "Ju si një shqiptar, si do ta kishit përshkruar femrën shqiptare të Turqisë?", janë marrë përgjigje të ndryshme, me anë të të cilave është tentuar të nxirret në shesh një profil i cilësive të gruas shqiptare në Turqi.

Te kjo pyetje është konstatuar se veçoritë më të dalluara dhe më të potencuara të gruas shqiptare në Turqi janë: "Amvise e mirë", "E dhënë pas familjes", "E ndershme", "E dhënë pas bashkëshortit", "Kujdeset për veshjen", dhe si të tilla këto cilësi të potencuara në përgjithësi kanë vlerësime të përshtatshme dhe pozitive, që jep të kuptohet se si të tilla pranoen nga shqiptarët e Turqisë.

Ndërsa kur bisedohet për veçoritë të cilat shihen si negative dhe të cilat nuk pëlqehen nga të intervistuarit është konstatuar se cilësitë të cilat nuk i përshtaten gruas shqiptare të Turqisë janë: "E mbyllur", "Pak e arsimuar" dhe "Dëshiron të tregohet". Sa u përket të arriturave në lidhje me grupin e të intervistuarve nga Maqedonia të përshkrimit të tyre të gruas shqiptare, ata kanë potencuar veçoritë në vijim: "E ndershme-e moralshme", "Pak e arsimuar", "Amvise", "E dhënë pas fëmijëve" dhe "E do luksozin-jetën moderne".

Prej të gjitha këtyre cilësive të theksuara, me përjashtim të thënies "Pak e arsimuar", që të gjitha janë vlerësuar si cilësi të preferuara dhe pozitive të gruas shqiptare në Maqedoni.

Nga cilësitë e theksuara e që nuk u përshtaten dhe si të tilla janë vlerësuar si negative, ndaj thënies "Pak e arsimuar" hyjnë edhe veçoritë sikur që janë potencuar "Mashkulli mbisundon", "Nuk është e lirë" e kështu me radhë.

4. Pyetja e katërt me radhë që u është parashtruar të intervistuarve të të dy shteteve ka qenë: "Ju si një shqiptar, si do t'i kishit përshkruar moshatarët tuaj shqiptarë të Maqedonisë/Turqisë"?

Te grupi i të intervistuarve nga Turqia veçori më të potencuara kanë dalë: "I janë përshtatur shoqërisë vendase", "Të dhënë pas familjes", "Të besës" dhe "Janë punëtorë". Që të gjitha këto veçori të cilat i kanë potencuar të intervistuarit nga Turqia, në bazë të vlerësimit të tyre janë pozitive dhe të përshtatshme për ta.

Ndaj këtyre cilësive të potencuara pozitive është konstatuar se ka cilësi të cilat nuk përfillen por që i posedojnë shqiptarët e Turqisë. Këtu më së tepërmi si pika më të dhimbshme paraqiten "Humbja e identitetit shqiptar", "Inatçorë-nervozë", "E pëlqejnë veten", "Janë të mbyllur" dhe "Nuk merren me politikë".

Sa u përket të arriturave në lidhje me këtë çështje të të intervistuarit nga Maqedonia është konstatuar se situata më aktuale në mesin e moshatarëve shqiptarë është: "Kombëtarë-trima", "Janë të papunë - kushte të rënda ekonomike", "Me karakter", "Gra të ndershme", "Të besës" dhe "Punëtorë".

Nga aspekti i vlerësimit të këtyre aktualiteteve të moshatarëve shqiptarë qartë është vënë në pah se me përjashtim të veçorisë "Janë të papunë - kushte të rënda ekonomike" të gjitha cilësitë e tjera janë vlerësuar si pozitive dhe të përshtatshme për të intervistuarit nga Maqedonia.

Është interesante se grupi i të intervistuarve meshkuj më së tepërmi kanë potencuar thënie në lidhje me gjendjen ekonomike ose çështjet e karakterit të shqiptarëve të këtyre trojeve dhe solidarizimit mes tyre. Ndërsa grupi i gjinisë femërore më së tepërmi ka përdorur thënie në lidhje me statusin e gruas në familje dhe shoqëri si dhe për karakterin e tyre në përgjithësi.

5. Kur janë pyetur shqiptarët e Turqisë me pyetjen e pestë në lidhje me jetën e profesionit apo punës që bëjnë, ata e kanë përshkruar veten se janë duke u marrë "Me tregti-zejtarë të vegjël" (54 thënie), "E bëjnë punën në përgjithësi" (40 thënie), "Janë punëtorë - luftëtarë në punë" (34 thënie), "Artarë" (34 thënie) dhe "Ëmbëltorë" (32 thënie).

Kur jemi te profesioni dhe karakteri i punës, këtu mund të radhiten edhe veçoritë : "Janë të sqingertë në punë", "Janë të suksesshëm", "Të aftë" e kështu me radhë. Është konstatuar se të gjithë të intervistuarit kanë potencuar pavarësinë e tyre në punë dhe organizimin e punës në mënyrë të pavarur si veçori më dalluese të shqiptarëve në Turqi.

Derisa te grupi i të intervistuarve nga Maqedonia si veçori më kryesore e tyre në aspekt të punës-profesionit janë konstatuar veçoritë: "Gurbetqarë" (60 thënie),

“Tregtarë-zejtarë të vegjël” (41 thënie), “Bujq” (36 thënie), “Punëtorë-luftëtarë në punë” (30 thënie), “Të zgjuar-kreativë” (26 thënie).

Në tabelë është parë qartë se nga të gjitha këto veçori të potencuara në lidhje me profesionin me përjashtim të ‘gurbetit’, të gjitha ato cilësi janë të përshtatura dhe pozitive për ta. E sa i përket çështjes së "gurbetit", kjo është paraqitur si dhimbje e pashërueshme për shqiptarët e këtyre trevave, me të cilën gjendje ata aspak nuk janë të kënaqur.⁴ Në këtë vlerësim mund të potencohet edhe papunësia e tyre në përgjithësi.

6. Pyetja e gjashtë e cila u është parashtruar të intervistuarve të të dyja shteteve ka qenë: "Ju si një shqiptar, si do t'i kishit përshkruar shqiptarët në aspekt të jetës familjare?" Grupi i të intervistuarve nga Turqia në lidhje me këtë çështje ka potencuar veçoritë siç janë: "Jetojnë në harmoni familjare" (54 thënie), "Të dhënë pas familjes" (42 thënie), "Babai është përgjegjës" (28 thënie), "mbahen mes veti" (28 thënie) "kanë respekt familjar" (24 thënie).

Nga të gjitha këto veçori të potencuara themi se, të gjitha vlerësimet janë pozitive dhe të përshtatshme për ta. Për sa u përket frekuencave mes gjinive është konstatuar se në lidhje me "mbisundimin e mashkullit në familje" grupi i të intervistuarve të gjinisë femërore kanë qëndrim negativ ndaj kësaj çështjeje.

Për sa u përket ngjashmërive mes meshkujve dhe femrave të intervistuar është konstatuar se në lidhje me "përgjegjësinë e babës në familje" ka një paralelizëm në qëndrimet e të dy gjinive. Kjo vërteton qëndrimin e njëjtë të shqiptarëve në Turqi sa i përket perceptimit të rëndësisë së babës në familjen shqiptare.

Ndërsa te grupi i të intervistuarve nga Maqedonia në lidhje me jetën familjare janë konstatuar këto veçori: "jetojnë në harmoni familjare"(48 thënie), "kanë respekt familjar"(42), "babai është përgjegjës"(40), "jetojnë bashkërisht"(28), dhe "e ndihmojnë njëri-tjetrin"(24).

Të tëra këto veçori në aspekt të vlerësimit janë konstatuar si të përshtatshme dhe pozitive, me përjashtim të veçorisë "jetojnë bashkërisht" ku shihet një mospërputhje mes të intervistuarve, disa nga të cilët i kanë paraqitur brengat e tyre në lidhje me këtë çështje.

7. Të arriturat në lidhje me pyetjen e shtatë paraqesin qëndrimet dhe aktivitetin e shqiptarëve në Maqedoni dhe Turqi në aspekt të jetës sociale.

Konstatimet në lidhje me grupin e të intervistuarve nga Turqia prezantojnë se ata jetën sociale të tyre e kalojnë me këto aktivitete: "shëtisin-bëjnë piknik"(40 thënie),"marrin

⁴ Vinca, Nuhi, “Kurbeti dhe Mërgimi në lirikën gojore të shkruar”, *Simpoziumi i Shqiptarëve në Maqedoni*, 1995, f. 183-192.

pjesë në dasma"(36), "merren me sport", "shkojnë në kafene"(34), "vizitojnë familjen" e kështu me radhë.

I vetmi aktivitet i cili është vlerësuar si negativ dhe i papërshtatshëm është konstatuar "shkuarja në kafene", ku shumica e të intervistuarve e kanë vlerësuar me pika të ulëta.

Derisa grupi i të intervistuarve nga Maqedonia jetën sociale të tyre e kanë paraqitur në këtë mënyrë: "shkojnë në kafene" (56 thënie), "merren me sport"(32), "e kalojnë në shtëpi me familjen"(28), "vizitojnë farefisnin" dhe ndjekin jetën kulturore.

Veçori të tjera pozitive të tyre janë potencuar: "shkojnë në pushim, merren me politikë, ndihmojnë të tjerët dhe prezantojnë në biseda të mbrëmjes" etj.

Ndërsa si veçori negative janë konstatuar: "e duan shumë zbavitjen, merren me thashetheme, kohën e kalojnë bosh e kështu me radhë.

b. Të arriturat lidhur me perceptimin e identitetit fetar

1. Me anë të katër pyetjeve të parashtruara në lidhje me qëndrimet dhe perceptimet e jetës fetare kemi pasur për qëllim që t'i analizojmë të gjitha sferat e jetës së tyre në të cilat haset koncepti fetar. Gjithashtu qëllimi i këtyre pyetjeve ka qenë nxjerrja në shesh në mënyrë sa më të saktë e ndikimit të fesë në jetën e tyre të përgjithshme.

Dhe mu për atë, pyetja e parë që u është parashtruar të intervistuarve ka qenë: "Ç'kuptojnë ata me jetën fetare?", të cilën çështje të intervistuarit nga Turqia e kanë përshkruar me këto veçori: "janë të dhënë pas fesë"(38 thënie), "kanë jetë fetare të mirë" (28), "falin namaz"(26), dhe "agjërojnë" (24) etj.

Të gjitha këto veçori i kanë vlerësuar si pozitive dhe të përshtatshme për ta, me përjashtim të një brengje të cilën e kanë potencuar në lidhje me "interesimin e paktë të rinisë ndaj fesë".

Kurse për të intervistuarit nga Maqedonia jeta fetare paraqet: "janë fetarë", "i respekton rregullat fetare", "feja ka ndikim në jetën e përditshme të tyre, "dëshirojnë realizimin e mësim besimit në institucionet arsimore" dhe "mbrojnë interesat fetare".

Për ta jetën fetare e përbëjnë edhe aktivitetet e ndihmës ndaj objekteve fetare dhe dërgimi i fëmijëve në mektep.

Si veçori negative e jetës fetare për ta është: "janë fetarë vetëm me gjuhë dhe kanë pak njohuri fetare".

2. Për sa i përket besimit fetar, shqiptarët nga Turqia veten e kanë përshkruar me këto cilësi të besimit: "besojnë Allahun (76 thënie), "kanë besim fetar të plotë"(44), "u

besojnë librave të shenjtë" (42), "besojnë në profetët dhe besojnë në melekët" e kështu me radhë.

Si veti negative të cilat i kanë paraqitur ata në aspekt të besimit fetar është konstatuar "besimi në gjërat boshe / besëtytni" si p.sh. udhëtimi ditën e martë, besimi në horoskop etj.

Grupi i të intervistuarve nga Maqedonia me përshkrimin që u kanë bërë shqiptarëve po nga Maqedonia, duke u nisur nga thëniet më të përsëritura, veten e kanë përshkruar si njerëz të cilët: "besojnë Allahun"(80 thënie), "besojnë në librat e shenjtë" (48), "besojnë në profetët" (42), "besojnë në melekët"(36), "besojnë në ditën e gjykimit" dhe "besojnë në përcaktimin e Allahut"(32).

Të gjitha këto veçori të sipërpërmendura të intervistuarit i kanë vlerësuar si pozitive dhe të përshtatshme për ta. Këtu hyjnë edhe qëndrimet e tyre se besimi ka ndikim në jetën e përditshme të tyre dhe se për hir të besimit fetar bëjnë mirësi të ndryshme.

Sa u përket qëndrimeve negative në lidhje me çështjet e besimit fetar, është konstatuar se kanë perceptime të ngjashme me të intervistuarit nga Turqia në lidhje me "besimet e kota".

3. Pyetja që u është parashtruar të intervistuarve në lidhje me veprat fetare (ibadetet) ka pasur për qëllim nxjerrjen në shesh të nivelit dhe mënyrës së adhurimit dhe sjelljeve fetare.

Në lidhje me këtë pyetje të intervistuarit nga Turqia ibadetet të cilat i kryejnë i kanë përshkruar me këtë radhitje: "e agjërojnë ramazanin", "e falin namazin", "e kryejnë haxhin", "e japin zeqatin", "e falin namazin e xhumasë" etj.

Të gjitha këto adhurime të lartpërmendura hyjnë në kategorinë e ibadeteve obligative (farz). Ndërsa nga ibadetet që nuk janë farz e që shqiptarët e Turqisë janë duke i kryer mund të numërohen: "prerja e kurbanit, falja e bajrameve, dhënia e sadakatu'l-fitrit, dhënia e lëmshës, falja e namazit të taravisë" etj.

Prej kategorive të ibadeteve, konstatim brengosës të intervistuarit kanë shprehur në lidhje me haxhin duke potencuar se shqiptarët në përgjithësi "shkojnë në haxh në pleqëri" dhe në lidhje me "rininë e cila dobët falë namaz".

Sa u përket të intervistuarve nga Maqedonia në kategorinë e ibadeteve farz radhitja e tyre është identike me atë të të intervistuarve nga Turqia.

Ndërsa në kategorinë e ibadeteve të cilat njihen si vaxhib ata kanë paraqitur këto veprimtari fetare: "japin sadakatu'l-fitër, presin kurban" etj.

Në mesin e veprimtarisë fetare të tyre hyjnë edhe ibadetet me karakter social siç janë "dhënia e lëmshës-ndihma të varfërve, festimi i festave fetare, këndimi i mevludit, ndihma ndaj institucioneve fetare" e kështu me radhë.

Duhet theksuar se në aspekt të formave të ibadeteve me të cilat nuk pajtohen të intervistuarit dhe si të tilla i kanë vlerësuar me qëndrim negativ hyjnë: "shkuarja në pleqëri në haxh, dhënia e zeqatit nga shumë pak njerëz dhe numri i ulët i të rinjve që falin namaz.

4. Të arriturat në aspekt të dimensionit ndikues të fesë paraqesin se të intervistuarit nga Turqia prezencën e fesë në jetën e tyre të përditshme e kanë përshkruar kështu: "feja ka ndikim"(50 thënie), "feja ndikon në jetën tregtare të tyre" (32), "e kanë frikë Allahun" (24), "feja ndikon në moral" (16), dhe "feja nxit në vepra të mira-tolerancë" (16).

Ndaj këtyre veçorive, me rëndësi të posaçme janë konstatuar edhe ndikimi fetar "në bamirësi, veshje, edukimin e fëmijëve në frymën fetare, respektin familjar" e kështu me radhë.

Megjithatë te grupi i të intervistuarve nga Turqia ka disa shqetësime lidhur me ndikimin dhe mosndikimin e fesë në jetën e përditshme të shqiptarëve të Turqisë, ku si për ilustrim e kanë potencuar mosndikimin e fesë në tregti.

Të intervistuarit nga Maqedonia në aspekt të ndikimit fetar në jetën e përditshme veten e kanë përshkruar me këto veçori: "feja ka ndikim" (64 thënie), "veçanërisht ndikon në moral" (30), "në aplikimin e ibadeteve"(24), "në frikën ndaj Allahut"(22), "ndikon në identitetin tonë kombëtar"(20) etj.

Nga këto veçori të potencuara konstatohet se të gjitha janë vlerësuar si pozitive dhe të përshtatshme, që jep të kuptojmë se feja si faktor ka peshën e vet në jetën sociale të shqiptarëve.

Si veçori negative të cilat i kanë paraqitur të intervistuarit nga Maqedonia mund të numërohen: "feja ndikon pak në gjeneratat e reja" dhe "Zotin e kujtojnë vetëm kur janë në zor".

DISKUTIM DHE PËRFUNDIM:

Ky punim, si hulumtim shkencor i realizuar në degën e psikologjisë së religjionit, ka analizuar perceptimet e një grupi shqiptarësh të Maqedonisë dhe Turqisë në lidhje me identitetin social dhe jetën fetare. Si i tillë qëllim final të vetin ka pasur që në bazë të njohurive sa më të gjera (sipërfaqësore) dhe objektive të arrijë të nxjerrë një profil të shqiptarëve të këtyre dy shteteve në konceptet dhe qëndrimet e tyre ndaj identitetit etnik dhe fetar.

A. Perceptimi i identitetit social

Në bazë të të arriturave del në shesh se cilësitë: "të besës" dhe "tolerues" janë veçoritë identike dhe pozitive për të dyja grupet e të intervistuarve. Kështu që mund të thuhet se shqiptarët me këto dy cilësi mburren dhe janë krenarë, në veçanti cilësia "të besës", e cila qysh nga shkrimtarë të hershëm kombëtarë ka qenë lëndë studimi dhe u ka shërbyer si frymëzim në arritjen e realizimit të veprave të tyre. Një ndër ata që është marrë në veçanti me këtë veçori të shqiptarit është edhe i madhi Sami Frashri, i cili me veprën e tij "BESA"⁵ këtë cilësi e potencon në veçanti si virtyt më i spikatur i shqiptarit, e që në bazë të të arriturave tona na asocon se edhe sot e kësaj dite kjo cilësi vazhdon të jetë një ndër cilësitë më të rëndësishme të shqiptarëve.

Një ndër veçoritë më të potencuara të grupit i të intervistuarve nga Turqia është: "janë punëtorë", që na bën me dije se vetë shpërngulja e tyre në rrethana të ndryshme ekonomiko-sociale i ka detyruar ata që për të ecur baras me popullin tjetër është dashur një mund i posaçëm dhe angazhim i madh që të arrijnë deri në pavarësinë ekonomike të tyre.

E në anën tjetër me potencimin e "përshtatjes ndaj popullatës" kanë për qëllim identifikimin me shoqërinë turke. Ky fenomen, ashtu siç e paraqesin studimet socio-psikologjike, paraqet një sjellje përshtatëse (conformity) të pakicës ndaj grupit dominues.⁶

Ndërsa potencimi i veçorisë "janë kombëtarë-trima" nga ana e grupit të intervistuar nga Maqedonia, ka për qëllim ndriçimin e faktit se ata veten nuk e shohin si pakicë, porse pikë synimi të vetin kanë detyrimin që edhe të tjerët (maqedonasit) t'i njohin këta si një komb i cili paraqet 1/3 e popullatës së përgjithshme. Në të njëjtën kohë, paraqitja e "shtypjes dhe e padrejtësisë të cilën e bën sistemi shtetëror" ndaj shqiptarëve me siguri që ka qenë shkas i kryengritjes dhe luftës së shqiptarëve për

⁵ Frashëri, Sami, *Vepra I*, Tiranë, 1988, f. 9-14.

⁶ Arkonaç, Sibel, *Grup Ilişkileri*, Stamboll, 1998, f. 69-90.

realizimin dhe sigurimin e të drejtave të tyre në sistemin shtetëror, arsim dhe jetën sociale.

Edhe në aspekt të identitetit të mashkullit edhe femrës shqiptare janë tubuar të dhëna të cilat i kanë ofruar të intervistuarit e të dyja shteteve. Grupi i të intervistuarve nga Turqia veçoritë kryesore të mashkullit shqiptar në Turqi i konsiderojnë: "punëtorë, të besës dhe të dhënë pas familjes".

Me potencimin e veçorisë "janë punëtorë", si duket kanë për qëllim prezantimin e vetvetes si të suksesshëm në punë, të aftë, iniciatorë të mirë dhe vetëveprues në punë d.m.th të pavarur ekonomikisht.

Kognicionet e perceptimeve në lidhje me veçorinë "të dhënë pas familjes" paraqesin interesimin e tyre në sigurimin e harxhimeve familjare, interesimin ndaj fëmijëve edhe udhëheqësinë familjare. Këto veçori si duket janë të njëjta te shqiptarët në përgjithësi.

Edhe shqiptarët e Maqedonisë në përshkrimin e mashkullit shqiptar kanë perceptime dhe kognicione identike me ata të Turqisë, me përjashtim të potencimit të tyre se "janë në tentativë arsimore dhe janë individë të cilët e duan arsimin". Po qese vërejmë nga ky kënd i perceptimeve duhet thënë se populli shqiptar i këtyre trevave në kohët e fundit në çështjet e vetë arsimimit ka qëndrime jashtëzakonisht pozitive. Shqiptarët edhe në ish Jugosllavi por edhe në R. e Maqedonisë në aspekt të arsimit kanë qenë të diskriminuar, gjë që edhe sot në Maqedoni në universitetet shtetërore shqiptarët janë të përfaqësuar me 2,5% edhe pse si popullatë përbëjnë 1/3 e popullsisë së përgjithshme.⁷

Këtë dashamirësi arsimore ata e realizuan me anë të përkrahjes së popullatës shqiptare duke hapur Universitetin e Tetovës në vitin 1994. Edhe ndaj të gjitha obstrukcioneve të organeve shtetërore ai Universitet vazhdon punën e tij me tempo të plotë. Në fillim të punës arsimore në këtë Universitet u regjistruan diku rreth katër mijë studentë të rinj e sot ka mbi dymbëdhjetë mijë studentë në drejtime të ndryshme.

Sa u përket perceptimeve në lidhje me gruan shqiptare te të dy grupet e të intervistuarve janë potencuar veçori të njëjta dhe vlerësim identik ndaj përshkrimit të gruas shqiptare. Ndër veçoritë më të dalluara kanë përmendur: "amvise, e dhënë pas familjes, e ndershme, kujdeset për fëmijët etj.

Këtu duhet potencuar dallimin në konceptin mes gjinive në lidhje me statusin e femrës dhe sovranitetin (mbisundimin e burrit) ku grupi i gjinisë femërore ka paraqitur vërejtjet e tyre në lidhje me këto çështje me qëllim të potencimit të dëshirës për të qenë "më e lirë" dhe për të rikujtuar nevojën e ndryshimit të disa gjërave në këtë drejtim.

Në lidhje me jetën sociale të gruas shqiptare te të dy grupet e të intervistuarve perceptimet e tyre anojnë në drejtim "të veshjes dhe jetës luksoze". Sa i përket

⁷ Zajazi, Tahir, "Prania e Elementit Shqiptar në Univerzitetin Kiril e Metodij të Shkupit në periudhën 1947-1991", *Simpoziumi i Shqiptarëve të Maqedonisë*.

"amvisërisë" nga të arriturat konstatojmë se tash për tash gruaja shqiptare si duket e ka pranuar një rol të tillë pa kurrfarë ankese - pakënaqësi.

Të arriturat na vërtetojnë se gruaja shqiptare në aspekt të fetarisë është shumë më e devotshme dhe më e dhënë pas fesë sesa mashkulli shqiptar.

Te të dy grupet e të intervistuarve gjendje e pakënaqshme është paraqitur "arsimimi i dobët i gruas shqiptare". Mirëpo siç duket një botëkuptim i tillë ka ngelur në të kaluarën, e sa i përket aktualitetit sot mendimet dhe qëndrimet e shqiptarëve në lidhje me arsimimin e femrës shqiptare kanë lëvizur në drejtimin pozitiv.

Një veçori tjetër negative është shprehur me thënien "të mbyllura" me çka nënkuptohet mospjesëmarrja e tyre në poret e jetës sociale dhe punësimit të tyre. Arsyeja është arsimimi i dobët i tyre. Por këtu s' duhet harruar edhe mungesën e madhe të shoqatave apo asociacioneve të grave, organizimi i paktë i aktiviteteve të ndryshme kulturore etj.

Pyetja që është parashtruar për moshën dhe moshatarët e të intervistuarve ka pasur për qëllim analizimin dhe konstatimin e marrëdhënieve mes gjeneratave si dhe përshtatshmërinë apo konfliktet mes tyre. Të intervistuarit nga Turqia në lidhje me këtë pyetje i kanë reflektuar këto perceptime: "i janë përshtatur popullatës turke, të dhënë pas familjes, të besës, punëtorë dhe të dhënë pas fesë". Ndërsa te ata të Maqedonisë janë konstatuar këto kognicione: "kombëtarë, me karakter, punëtorë, të arsimuar dhe të dhënë pas familjes".

Prej të intervistuarve nga Turqia u konstatua se çështje më e rëndësishme për ta është integrimi i tyre në shoqërinë turke, që për ta paraqet një kënaqësi realizimi me sukses i këtij integrimi në ato rrethana dhe si të tillë nuk dëshirojnë ta dallojnë veten nga popullata turke. Në këtë integrim të tyre si duket faktor më i rëndësishëm ka qenë feja, çka lirisht mund të themi se në atë mjedis feja luan rol të afërimit dhe bashkimit të njerëzve me identitet të ndryshëm etnik.

Te shqiptarët e Maqedonisë problematikë e rëndësishme është konstatuar "gjendja e rëndë ekonomike dhe papunësia". Ku shumica prej tyre ekzistencën familjare e sigurojnë nga jashtë (gurbeti). Të gjitha këto konstatime, siç janë: "gjendja e rëndë ekonomike, papunësia, kurbeti", janë tregues të fortë se në këto pjesë ku jetojnë shqiptarët shteti maqedonas nuk ka bërë kurrfarë investimi. E njëjta gjë ka qenë edhe në sistemin e ish Jugosllavisë ku nëse në ndonjë vend të Maqedonisë perëndimore hapej ndonjë fabrikë, shteti punëtorët apo administruesit e saj i sillte prej Maqedonisë lindore (të etnitetit maqedonas).⁸

Si faktor i paraqitjes së disa veprimeve të padëshiruara mes gjeneratës së re, sikur që është përdorimi i narkotikëve ose inicimi i tyre për të bërë shitjen-stërshitjen e drogës; shkaktar të vetëm të kësaj gjendjeje të padëshiruar është diskriminimi ekonomik shtetëror ndaj shqiptarëve.

⁸ Poulton, Hugh, *The Balkanians*, Londër, 1991, f. 80-95.

Po qese bëjmë vlerësimin e të arriturave në lidhje me jetën e profesionit do të vërejmë se shqiptarët e Turqisë duke përshkruar veten në aspekt të profesionit në radhë të parë kanë zgjedhur "tregtinë, pronësinë e ndonjë vendi pune", ndaj kësaj veten e shohin të suksesshëm dhe në epërsi në profesionet e artizanateve. Në veçanti këtu hyjnë: "artaria, ëmbëltoria, zdrukthëtaria dhe hekërpunuesia e kështu me radhë".

Ndërsa për të intervistuarit nga Maqedonia punë apo profesion me të cilin merren shqiptarët e Maqedonisë në radhë të parë kanë potencuar : gurbetqarë (60 thënie), tregtarë-zejtarë të vegjël, bujq, punëtorë-luftëtarë në punë, të aftë, ëmbëltorë, artarë etj.

Kur vijmë në njërin prej pjesëve përbërëse të identitetit social te jeta familjare të arriturat tregojnë se të intervistuarit e të dy shteteve kanë perceptime identike. Brenda dimensioneve të të arriturave të këtij punimi mund të bëjmë një koment të këtillë: "harmonia familjare, lidhjet farefisnore, respekti, ndihma reciproke", janë veçoritë më kryesore të familjes shqiptare. Krahas kësaj, "përgjegjësia familjare e më plakut respektivisht babës" është veçori dhe element themelor i familjes shqiptare. Këto të dhëna na bëjnë me dije që botëkuptimi i konceptit familjar në mesin e shqiptarëve edhe sot e kësaj dite vazhdon dhe kultivohet me të njëjtin tempo si në të kaluarën.

Ndikim më të rëndësishëm në lidhje me këto kognicione supozojmë se kanë dy faktorë të rëndësishëm. Njëri është koncepti i Islamit ndaj familjes (këshillat kur'anore dhe fjalët e Muhamedit a. s.)⁹. Ndërsa si faktor i dytë me rëndësi konsiderohet botëkuptimi tradicional shqiptar i familjes.

Sa i përket mbisundimit të mashkullit në familje grupet e intervistuarat të gjinisë femërore të të dy shteteve kanë qëndrime negative, që reflekton nevojën për ndryshim të këtij koncepti familjar.

"Jeta e përbashkët" si një ndër veçoritë e rëndësishme të konceptit familjar shqiptar, u konstatua se akoma vazhdon si fenomen por me disa ndryshime të vogla. P.sh. sot familjet e shqiptarëve jetojnë bashkë deri sa nuk e rregullojnë për secilin vëlla çështjen e banimit dhe martesës, e pas kësaj ata ndahen prej bashkësisë.

Kognicionet në lidhje me jetën sociale të shqiptarëve, deri diku kanë dalë identike mes grupeve të intervistuarat të të dy shteteve. Tek shqiptarët e Turqisë me jetë sociale perceptohet: "pikniku, shëtitja, marrja me sport, vizita familjare, shkuarja në kafene" etj. Krahas kësaj, një pjesë e tyre është e kyçur dhe ndjek me vëmendje aktivitetet e shoqatave shqiptare në Turqi, të cilat si duket luajnë rol të posaçëm në ruajtjen dhe kultivimin e traditës shqiptare.¹⁰

⁹ Shih: Ku'ran-i Kerimi, Isra:23,24; Lokman 14; Nisa 36; Ankebut 8 etj.

¹⁰ Mes shoqatave shqiptare të Turqisë më me rëndësi konsiderohen: "Shoqata e Rumelive", "Shoqata për Vëllazërim të Shqiptarëve dhe Turqve", "Shoqata e Prizrenasve" etj.

Për të intervistuarit nga Maqedonia jetë sociale do të thotë: "marrje me sport, kalimi i kohës në familje, vizita të ndryshme, pjesëmarrje në aktivitete të shoqatave, jeta kulturore (kinema-teatër) etj.

Është interesante se ankesë e përbashkët e të dy grupeve nga të dy shtetet në lidhje me jetën sociale paraqitet "shkuarja në kafene dhe të marrit me përgojime dhe thashetheme.

B. Perceptimet e jetës fetare

Në bazë të të arriturave të studimit tonë është konstatuar një botëkuptim paralel brenda konceptimit të jetës fetare te të dy grupet e intervistuar. Sa për ilustrim edhe të intervistuarit nga Maqedonia edhe ata nga Turqia në lidhje me veçorinë "janë fetarë të mirë", kanë shprehur nga 24 thënie që argumenton hipotezën dhe konstatimin tonë që fenomeni fe është pjesë e pranuar në marrëdhëniet e tyre sociale dhe si e tillë paraqet një normë të cilën ata e respektojnë.

Megjithatë në lidhje me njohuritë fetare që të dy grupet e kanë paraqitur gjendjen e palakmueshme të shqiptarëve rreth njohurive fetare. Për të intervistuarit shqiptarë nga Maqedonia pengesë kryesore konsiderohet mosintegrimi i mësim besimit në arsim. Sido qoftë, qëndrimet e shqiptarëve në lidhje me dimensionet e jetës fetare në përgjithësi janë konstatuar si pozitive dhe të përshtatshme për ta, me përjashtim të pakënaqësive të cilat i përmendëm.

Ndërsa sa i përket çështjes se dimensionit të besimit fetar që të dy grupet e të intervistuarve me disa dallime të vogla kanë paraqitur veçori identike, që jep të kuptojmë se kushtet e besimit fetar janë ato cilësi të cilat janë më të potencuara nga të dyja palët dhe se si të tillë ato kanë perceptime dhe kognicione të shëndosha në besimin e vet fetar. Këtu duhet përmendur se te të dy grupet e të intervistuarve më së tepërmi janë potencuar thënie në lidhje me kushtet e besimit siç janë: besimi në Allah, në Melek, në Pejgamber, në libra të shenjtë e kështu me radhë.

Dimensioni i adhurimit (ibadetit) apo riteve fetare është parashtruar si pyetje e dhjetë me radhë dhe ka nxjerrë në shesh rregullsinë e kryerjes së këtyre riteve fetare nga ana e shqiptarëve të Maqedonisë dhe Turqisë.

Prej ibadeteve që janë të kategorisë së obligimeve të domosdoshme (farz dhe vaxhib) është konstatuar se te të dy grupet e të intervistuarve si ibadet më i potencuar dhe më i përshtatshëm për ta është verifikuar "agjërimi". Te të dy grupet e të intervistuarve "agjërimi" ka dalë si veçori më pozitive dhe më e përsëritur. Te grupi i të intervistuarve nga Turqia kjo veçori është potencuar me 74 thënie edhe me 444 pikë, ndërsa te të intervistuarit nga Maqedonia kjo thënie është shprehur 86 herë dhe

gjithsejtë ka marrë vlerësim me 456 pikë. Ky është një tregues i shëndoshë rreth asaj se sa "ibadeti i agjërimit" është i rëndësishëm te shqiptarët.

Sa i përket muajit të Ramazanit dhe shqiptarëve në veçanti, sa për ilustrim mund të përmendet vepra e Wilfred Murad Hofmann-it i cili e ka konstatuar një respekt të posaçëm të shqiptarëve ndaj muajit të agjërimit, (ai në këtë punim përshkruan shqiptarët përkohësisht të punësuar në Beograd, për të cilët thotë edhe pse punonin punë të rënda por të gjithë agjëronin dhe pas iftarit merrnin pjesë në faljen e namazit të teravisë në Xhaminë e Beogradit).¹¹

Edhe hulumtimet e realizuara nëpër vendet e ndryshme që më parë kanë vërtetuar agjërimin si ibadet i cili ka përqindje të lartë të realizimit, që do të thotë se këto të arritura të punimit tonë prezantojnë një paralelizëm me punimet e bëra më parë në lidhje me jetën fetare.

Megjithatë duhet cekur se krahas asaj që "agjërimi" është konstatuar si ibadet i cili realizohet më së tepërmi nga ata, këtu duhet nënvizuar se edhe ndaj ibadeteve tjera siç janë namazi, haxhi, zeqati dhe tjerat, shqiptarët e të dy vendeve kanë qëndrime pozitive në lidhje me dimensionin e ibadetit fetar. Pa marrë parasysh se në lidhje me kryerjen e haxhit kanë prezantuar disa shqetësime të tyre në lidhje me shkuarjen në haxh në moshën e pleqërisë, ose në lidhje me zeqatin për çka potencojnë se pak njerëz e japin atë; sido qoftë si përfundim mund të themi se qëndrimet dhe perceptimet e shqiptarëve në lidhje me ibadetet fetare janë të përshtatshme dhe pozitive.

Përveç këtyre potencimeve duhet theksuar se në jetën e shqiptarëve muslimanë jashtë kryerjes së këtyre obligimeve të domosdoshme ka edhe aktivitete fetare të karakterit social-fetar. Një ndër ata është konstatuar "manifestimi i mevludit" (lindjes së Pejgamberit a. s.) është shumë i përhapur në mesin e shqiptarëve veçanërisht atyre të Maqedonisë. Sot ky manifestim te ata më së tepërmi realizohet nëpër shtëpi ku thirren mysafirë dhe dashamirë për të cilët përgatitet edhe ushqim i posaçëm. Një traditë e këtyre ditëve vazhdon në mesin e tyre si një aktivitet dhe sjellje e arsyeshme fetare.

Potencimi i "ndihmës ndaj institucioneve fetare" reflekton perceptimin e shëndoshë të tyre në mirëmbajtjen e institucioneve arsimor-fetare siç është medreseja "Isa Beu" dhe "Fakulteti i Shkencave Islame" në Shkup.

Sa për ilustrim, në lidhje me atë që është thënë për të arriturat e këtij punimi, këtu do të paraqesim vetëm disa nga të gjitha ato tabela të këtij punimi ku mund të vërehen edhe më qartë rezultatet dhe thëniet e shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Turqisë për sa i përket identitetit kombëtar dhe atij fetar të tyre.

Këtë e bëjmë me qëllim të kuptimit sa më të drejtë të metodës dhe qëllimeve të këtij punimi nga ana e lexuesve.

¹¹ Hofmann, Wilfred Murad; "Journal d'un Musulman Allemand", Rabat-Maroko, 1990, f. 28.

Pyetja 1. "Ju si shqiptar si do t'i kishit përshkruar shqiptarët e Turqisë?"

Thëniet	GJINIA			Pr+ (6)		Pr. (5)		Pr-(4)		Np+ (3)		Np.(2)		Np-(1)		Pikët		p.t
	f	m	N	f	m	f	m	f	m	f	m	f	m	f	m	f	m	
Të integr. në shoq. turke	23	34	57															
1. Të integruar në shoqëri	6	11	17	3	10	3			1							33	64	97
2. Të pajtueshëm	7	8	15	6	7	1			1							41	46	87
3. Kombëtarë-atdhetarë	1	5	6	1	5											6	30	36
4. Mikpritës	5	1	6	5	1											30	6	36
5. Solidarë	2	4	6	1	3	1			1							11	22	33
6. S'kanë probleme	1	3	4						2			1			1	2	9	11
7. Të kulturuar-modernë	1	2	3	1	2											6	12	18
Puna-Profesioni	20	24	44															
1. Janë punëtorë	11	13	24	6	12	4		1				1				60	74	134
2. Themelues pune	3	4	7		3	1		1	1	1	1					12	25	37
3. Gjend. mirë ekonomikisht	3	4	7	1	1	1	1			1	1				1	14	15	29
4. Janë të aftë	2	1	3	2	1											12	6	18
5. S'bëjnë punë shteti	1	2	3					1	1						1	4	5	9
Personaliteti - karakteri	7	24	31															
1. Të besës-sinqertë	3	16	19	1	14	2					1				1	16	88	104

2. Inatçorë-nervozë	2	3	5				1					1	1	1	1	3	8	11
3. E pëlqejnë veten	1	3	4		1				1						2	3	8	11
4. Me karakter-moral	1	2	3	1	2											6	12	18
Tradita dhe feja	11	12	23															
1. Të dhënë pas traditës	8	8	16	6	7	1		1	1							45	46	91
2. Fetarë-të dhënë në fe	3	4	7	2	3	1	1									17	23	40
Jeta familjare - solidarë	8	15	23															
1. T' dhënë pas familjes	5	7	12	5	5		1								1	30	36	66
2. Solidariz. mes vete	2	6	8	2	2						1				3	12	18	30
3. Gjuha shqipe harrohet	1	2	3									1			2	2	2	4

Tabela 11: Të intervistuarit nga Turqia dhe deklaratimet e tyre në lidhje me grupin e origjinës.

Pyetja 1: "Ju si shqiptar si do t'i kishit përshkruar shqiptarët e Maqedonisë?"

Thëniet	Gjinia			Pr		Pr		Pr-		Np+(3)		Np.(2)		Np-		Pikët		
	f	m	N	f	m	f	m	f	m	f	m	f	m	f	m	f	m	p.t
Kombi-Solidariteti	20	43	63															
1. Kombëtarë-trima	11	19	30	9	18			1		1				1	61	109	170	
2. Të pajtueshëm	5	8	13	5	8										30	48	78	
3. S'kanë qëndrim politik	1	6	7		1			1						5	4	11	15	
4. Asimilimi	2	3	5										2	3	2	3	5	
5. Atdhedashës		4	4		4											24	24	
6. Solidarë mes vete.	1	3	4	1	1									2	6	8	14	
Personaliteti-karakteri	26	35	61															
1. Të besës-të sinqertë	9	15	24	9	9			2				1		3	54	67	121	
2. Me karakter-moral	3	5	8	3	4					1					18	27	45	
3. E pëlqejnë veten	2	4	6	2			2	2							12	18	30	
4. Inatçorë-nervozë	3	3	6					2	1			1		2	10	6	16	
5. Të ndershëm	1	3	4	1	3										6	18	24	
6. Xhelozë	4		4					1					3		7		7	
7. T' dhënë pas interesit		4	4										4		4		4	
8. Thashethënës – të mbyllur	4	1	5										4	1	4	1	5	

Tradita-jeta sociale	16	19	35														
1. Bujarë-t' dhimbshëm	4	5	9	4	5										24	30	54
2. Respektojnë të vjetrit	3	4	7	1	3		1	1					1		11	23	34
3. Mikpritës	3	3	6	3	3										18	18	36
4. T' dhënë pas traditës	3	3	6	2	3			1							16	18	34
5. T' dhënë pas familjes	1	3	4	1	3										6	18	24
6. Shëtisin-turistë	2	1	3	1				1	1						7	4	14
Puna-jeta profesionale	9	15	24														
1. Janë punëtorë	4	6	10	3	6							1			20	36	56
2. Të aftë-iniciatorë	3	3	6	3	3										18	18	36
3. Gjend. ekon.-normal	1	2	3	1					1					1	6	5	11
4. Kanë negativ.-droga	1	2	3										1	2	1	2	3
5. Gurbetçinj		2												2		2	2
Janë fetarë	6	11	17	6	8		2							1	36	59	95
Të shtypur-padrejtësi	4	11	15					4	7				1	3	16	33	49
Të arsimuar-e duan	2	3	5	2	3										12	18	30
Pak të arsimuar	1	3	4						2				1	1	1	10	11

Tabela 12: Thëniet e theksuara nga të intervistuarit e Maqedonisë në lidhje me origjinën.

L I T E R A T U R A:

Arkonaç, Sibel, *Grup İlişkileri*, Stamboll 1998.

Arslantürk, Zeki, *Sosyal Bilimciler İçin Araştırma Metod ve Teknikleri*, M.U. İlahiyat Fakültesi, Stamboll, 1995.

Berger, L. Peter, *Identity as a Problem in the Sociology of Knowledge*, Londër, 1983.

Bilgin, Nuri, *Sosyal Psikolojide Yöntem ve Pratik Çalışmalar*, Sistem Yayıncılık, Stamboll, 1995.

Brown, B. L., *The Psychology of Religion: An Introduction*, Londër, 1988.

Frashëri, Sami, *Vepra I*, Tiranë, 1988.

Hofmann, Wilfred Murad, *Journal d'un Musulman Allemand*, Rabat-Marokë, 1990.

Hutchinson, John & Smith, Anthony D., *Ethnicity*, Oxford University Press, 1996.

Ku'ran-i Kerimi

Poulton, Hugh, *The Balkanians*, Londër, 1991.

Uysal, Veysel, *Dini Tutum, Davranış ve Şahsiyet Özellikleri*, Stamboll, 1996.

Vinca, Nuhi, "Kurbeti dhe Mërgimi në lirikën gojore të shkruar", *Simpoziumi i Shqiptarëve në Maqedoni*, Shkup, 1995.

Zajazi, Tahir, "Prania e Elementit Shqiptar në Universitetin Kiril e Metodij të Shkupit në periudhën 1947-1991"- *Simpoziumi i Shqiptarëve të Maqedonisë*, Shkup, 1995.